



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 9  
17.07.2013

NR. VENDIMI 6  
19.07.2013

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

**Ardit MUSTAJ - GJYQATAR**

Asistuar prej sekretares Olta Sinanaj, sot me dt.19.07.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike kërkesën e paraqitur prej:

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, e përfaqësuar nga prokurori Ened Nakuçi.

**OBJEKTI:** Sekuestrim pasurie.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3-7, 11, 12, 14, 15 e vijues të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe dëgjoi prokurorin që kërkoi pranimin e kërkesës,

**VËREN se:**

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, me dt.xxx, ka filluar procedimin pasuror mbi bazën e ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndaj shtetasit shqiptar K.F., i biri i F. dhe V., i dtl.xxx, lindur në xxx dhe banues në xxx.

Hetimi pasuror ka filluar për shkak se ky shtetas, me vendimin penal nr.xxx, dt.xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, është deklaruar fajtor dhe është dënuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/1 e 25 të

K.Penal, në lidhje me trafikimin, në bashkëpunim me shtetasit R.K., B.K., etj. të një sasive prej x (xxx) kg lëndë narkotike kokainë nga xxx drejt xxx, e cila i është sekuestruar me dt.xxx shtetasit xxx xxx xxx gjatë transportimit të saj me automjet. Edhe këta të fundit janë dënuar në vitin xxx dhe xxx nga Gjykata e xxx në xxx për këtë veprë penale të kryer në bashkëpunim edhe me shtetasin K.F.

Nga hetimi pasuror i kryer nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka rezultuar se me kontratën e shitjes nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx shtetësja V.F. në cilësinë e blerëses, e përfaqësuar me prokurë nga djali i saj K.F., ka blerë nga shoqëria “xxx xxx xxx”, një apartamenti banimi me nr.xxx, shkalla x-rë, kati xxx-të (dupleks), me sipërfaqe xx m<sup>2</sup>, me strukturë xxx (dy dhoma, një kuzhinë dhe ambiente të tjera ndihmëse), i ndodhur në lagjen xx, Plazh xxx, në zonën kadastrale xxx, pasuri e regjistruar me numër xxx, volumi xx, faqe xxx, në ZRPP xxx. Sipas kontratës së shitjes, vlera e apartamentit është në shumën xxx(xxx) lekë, e cila rezulton se është paguar tërësisht nga blerësi.

Me anë të kërkesës objekt gjykimi, Prokuroria për Krime të Rënda, në bazë të neneve 3 dhe 11 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009, kërkon që të vendoset nga gjykata sekuestrimi i pasurisë së sipërpërmendur të blerë nga shtetësja V.F. e përfaqësuar nga K.F., si subjekte të veprimit të këtij ligji, i dyti si subjekt i drejtëpërdrejtë i tij pasi është dënuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, ndërsa e para si gjini e afërt me të, konform pikave 1/ç dhe 2/a të nenit 3 të këtij ligji. Sipas prokurorisë, nga hetimi pasuror i kryer nuk ka rezultuar që shtetasi K.F. dhe familjarët e tij të kenë të ardhura të ligjshme që të justifikojnë pasurinë e mësipërme të blerë në emër të nënës së tij dhe se ekziston rreziku i tjetërsimit të saj dhe pamundësisë së zbatimit të masave të këtij ligji. Bashkëngjitur kërkesës nga prokuroria janë paraqitur edhe aktet dhe provat që vertetojnë rrethanat e mësipërme.

Gjykata, çmon se kërkesa e prokurorisë për sekuestrimin e pasurisë duhet pranuar pasi plotësohen kriteret e kërkuara nga nenet 3 dhe 11 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Neni 11/1 i ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 në të cilin bazohet kërkesa e prokurorit, konkretisht parashikon:

*“1. Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:*

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.

...”

Siç u përmend edhe më lart në vendim, rezulton se shtetasi K.F. është deklaruar fajtor për një nga veprat penale të parashikuara nga neni 3 i ligjit nr.10192, dt.3.12.2009. Për këtë arsye gjykata konstaton se përmbushet plotësisht (madje tejkalohet) kërkesa e neneve 3 dhe 11 të ligjit, sipas të cilave për zbatimin e këtij ligji dhe, në rastin konkret, për vendosjen e masës së sekuestros ndaj pasurive të personave, duhet që ndaj këtyre të fundit të ekzistojë “...një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për: ...ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet ...283, 283/a ...të Kodit Penal”.

Në lidhje me këto të fundit, sipas K.Penal shqiptar të kohës së kryerjes së veprës penale, të gjitha veprimet e paligjshme që lidheshin me lëndët narkotike, përfshirë edhe ato që sot kualifikohen si trafikim i narkotikëve sipas nenit 283/a të K.Penal, kualifikoheshin sipas nenit 283 të tij. Veprimet që përbëjnë veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” të parashikuar nga neni 283/a i K.Penal të sotëm, por edhe ato të veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” të parashikuar nga neni 283 i K.Penal, si aktual ashtu edhe ai i kohës së kryerjes së veprës penale, përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009, bazuar në nenin 3/1/ç të tij.

Ligji nr.10192, dt.3.12.2009, përveç personave të dyshuar si të përfshirë në veprimtaritë kriminale të përcaktuara në pikën 1 të nenit 3, e shtrin fushën e zbatimit të tij edhe mbi pasurinë e gjinisë së afërt të subjekteve të përmendura në pikën 1. Në gjininë e afërt përfshihen, sipas nenit 3/2 gërma “a”, edhe të paralindurit (në këtë rast nëna) e subjektit K.F., shtetësja V.F., e bija e R. dhe A., e dt.xxx, e cila figuron të jetë blerësja e apartamentit të mësipërm të banimit.

Sipas nenit 3/4 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009, ai zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të personit në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji. Në rastin e pasurisë objekt gjykimi dhe zbatimit të ligjit në fjalë ndaj saj, duhet evidentuar se koha e blerjes së apartamentit është pas përfshirjes së subjektit K.F. në veprimtarinë e mësipërme kriminale për të cilin ai është dënuar. E kundërta do të përbënte pengesë për zbatimin e ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 ndaj kësaj pasurie.

Nga verifikimet që ka kryer prokuroria në lidhje me aktivitetet e mundshme ekonomike apo të ardhurat e ligjshme e të deklaruara nga ana e

subjektit K.F. dhe familjarëve të tij, sipas shkresave nr.xxx prot., dt.xxx dhe nr.xxx prot., dt.xxx të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nr.xxx, dt.xxx të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, nr.xxx prot., dt.xxx dhe nr.xxx prot., dt.xxx të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, nr.xxx prot., dt.xxx dhe nr.xxx prot., dt.xxx të Qendrës Kombëtare të Liçensimit, nr.xxx prot., dt.xxx dhe nr.xxx prot., dt.xxx të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nr.xxx prot., dt.xxx të Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI, nuk ka rezultuar ndonjë veprimtari ekonomike e deklaruar apo të ardhura dhe fitime të ligjshme e të deklaruara prej tyre, në mënyrë që të justifikohet blerja e apartamentit të sipërpërmendur.

Nga ana tjetër, gjykata vlerëson se në lidhje me pasuritë e paluajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, potencialisht ekziston në çdo kohë rreziku i tjetërsimit të tyre dhe i shkaktit të pamundësisë për të zbatuar masat parandaluese të parashikuara në këtë ligj, pasi kalimi i pronësisë apo tjetërsimi i tyre bëhet nëpërmjet kryerjes së veprimit juridik përkatës dhe regjistrimit të tij në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pa qenë e nevojshme edhe dorëzimi i sendeve të paluajtshme. Për pasojë, me ardhjen në djeni të një hetimi pasuror të mundshëm apo që po kryhet, në çdo kohë është i mundur tjetërsimi i sendeve të paluajtshme nga ana e subjektit të veprimit të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009. Në rastin në gjykim, megjithëse gjykata vëren se gjatë hetimit pasuror, nga aktet e paraqitura në gjykatë nga prokuroria, nuk rezulton të jenë kryer veprime thelbësore hetimore së fundmi prej mëse një viti, gjykata, mbi bazën e arsytimit të mësipërm, vlerëson se në momentin që asaj i bëhet prezent dhe i kërkohet marrja e masës parandaluese ndaj pasurisë së paluajtshme, ekziston rreziku real i tjetërsimit të kësaj pasurie nga subjektet e ligjit në fjalë dhe për rrjedhojë gjykata vlerëson se përmbushet edhe kërkesa e nenit 11/1 gërma “a” e ligjit nr.10192, dt.3.12.2009.

Gjykata sqaron se masa parandaluese e sekuestros sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009, është masë me karakter të përkohshëm, me afate të përcaktuara në ligj, që lidhet patjetër me ekzistencën e një hetimi pasuror të filluar dhe ka si qëllim ruajtjen e pasurive të të gjitha llojeve nga humbja apo tjetërsimi dhe në të njëjtën kohë heqjen e mundësisë së përdorimit të mëtejshëm të tyre në veprimtaritë kriminale. Kjo masë është në funksion të realizimit të qëllimit kryesor të hetimit pasuror që zhvillohet sipas këtij ligji, ai i konfiskimit të pasurisë kur vertetohen kushtet e parashikuara në këtë ligj.

Gjithashtu, gjykata sqaron se, megjithëse gjykimi i kërkesës për sekuestrim sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009, bëhet vetëm me pjesmarrjen e prokurorit (neni 12/1), subjektet e këtij ligji që preken nga masa parandaluese duhet të njoftohen nga gjykata për vendimin e dhënë në mungesë të tyre dhe ato kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit (nenet 14/2 dhe 27/1).

**P. K. A:**

Gjykata, bazuar në nenet 3, 5, 7, 11, 12, 14, 15, 26, 27 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe neneve 306 e vijues e 310 të K.Pr.Civile,

**V E N D O S I :**

1. Sekuestrimin e një apartamenti banimi me nr.xxx, shkalla x-rë, kati xxx-të (dupleks), me sipërfaqe xx m<sup>2</sup>, i ndodhur në lagjen xx, Plazh xxx, në zonën kadastrale xxx, pasuri kjo e regjistruar me numër xxx, volumi xx, faqe xxx, në pronësi të shtetasve V.F., blerë prej saj me kontratën e shitjes nr.xxx rep., nr.xxx kol., dt.xxx.

2. Administrator i pasurisë së sekuestruar caktohet E.B., pranë Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Për ekzekutimin e masës së sekuestror ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxx.

4. Ky vendim t’u njoftohet nga sekretaria e gjykatës, sipas rregullave procedurale civile, shtetasve K.F. dhe V.F.

Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë brenda 15 ditëve, ky afat për palët në mungesë fillon nga njoftimi i tyre.

**Tiranë, më 19.07.2013.**

**SEKRETARE  
OLTA SINANAJ**

**GJYQTAR  
ARDIT MUSTAJ**